

Liebe Eltern!

Të dashur prindër,

Sie können Ihrem Kind helfen mit diesen Texten in Ihrer Sprache ALBANISCH.

Ju mund ta ndihmoni fëmijën tuaj përmes këtyre teksteve të cilat janë në gjuhën tuaj, në SHQIP..

Ihr Kind geht in Deutschland in die Schule.

Fëmija juaj shkon në Gjermani në shkollë.

Hier wird im Unterricht DEUTSCH gesprochen.

Këtu gjatë mësimit flitet GJERMANISHT:

Ihr Kind muss DEUTSCH verstehen und sprechen, um gut und viel zu lernen.

Fëmija juaj duhet të mësojë të kuptojë e të flasë GJERMANISHT me qëllim që të mësojë mirë dhe shumë.

Am Anfang muss Ihr Kind lernen, deutsche Buchstaben und Wörter zu schreiben und zu lesen.

Në fillim fëmija juaj duhet të mësojë shkronjat gjermane me qëllim që të shkruajë e të lexojë fjalët.

Für Kinder, die Deutsch verstehen, ist im Schreibheft auf DEUTSCH erklärt, wie sie lernen sollen.

Për fëmijët, të cilët kuptojnë gjermanisht, shpjegimet se si duhet mësuar janë në GJERMANISHT në fletoren që përdoret për të shkruar.

Hier ist eine Übersetzung davon in Ihrer Sprache ALBANISCH.

Këtu keni një përkthim në gjuhën tuaj, në SHQIP.

Lesen Sie Ihrem Kind die Texte auf ALBANISCH vor, damit es besser versteht, was es tun soll.

Lexojani fëmijës suaj tekstet në SHQIP me zë të lartë, me qëllim që të kuptojë më mirë se çka duhet të bëjë.

Wenn Sie und Ihr Kind diesen Text auf ALBANISCH verstehen, können Sie beide hoffentlich besser verstehen, was die Lehrer und Lehrerinnen auf DEUTSCH zu Ihrem Kind sagen und was sie verlangen.

Nëse ju dhe fëmija juaj e kuptoni këtë tekst në SHQIP, ju me siguri do të mund të kuptoni më mirë se çka i thonë mësuesit e mësueses fëmijës suaj në GJERMANISHT dhe çka kërkojnë prej tij.

Vater, Mutter oder große Geschwister lesen vor, wie das Kind mit dem Heft lernen wird.
Das Kind schaut sich im Heft die großen Buchstaben mit den Punkten, Linien und Pfeilen an.

Babai, nëna, motrat e rritura ose vëllezërit e rritur lexojnë me zë të lartë si duhet të mësojë fëmija me fletoren. Fëmija këqyr me kujdes në fletore shkronjat e mëdha me pika, viza e shigjeta.

Na këqyr me kujdes ne, shkronjave!
Secila prej nesh të thotë ty: Kjo jam unë.
Këtë pamje dua të kem, pikërisht këtë.
Unë jam një shembull shumë i bukur.

Secila prej tyre të pyet: Më njeh ti mua përsëri?
Dhe cilën prej nesh e njeh ti sërish?
Të lutem, të lutem, mos na ngatërro me njëra-tjetrën!

Secila prej tyre të thotë: Më shkruaj kështu!
Kështu dëshiroj të më shkruash. Pikërisht kështu!



Pikat e bardha
të tregojnë ty,
se ku duhet të fillojë punën
lapsi yt për të na shkruar ne.

Vizat dhe shigjetat e përcaktojnë saktësisht
rrugën që duhet të ndjekë lapsi yt

Ne, shkronjat e shembujve me ngjyrë të kaltër,
kemi në trupin tonë një ose dy
ose tri pika të bardha:
Pika e parë është e madhe,
pika e dytë është e vogël,
pika e tretë është fare e vockël, një pikëzë.
Duke u nisur nga pikat
ti shkruan me majën e lapsit tënd
në tabelë ose në letër në mënyrë të atillë,
që nga ky bashkim të dalë një vizë e lakuar

Cila nga ne mund të jetë **njëra**
prej shkronjave të emrit tënd?
Preki lehtë të gjitha shkronjat!
Do të na shkruash në emrin tënd?
Tamam kështu siç po ta tregojmë ne ty këtu?

Nëse na merr ne si shembull,
ti **më vonë** do mund t'i lidhësh **mirë**
me njëra-tjetrën shkronjat që do të mësosh

të shkruash **pak nga pak**.
Kjo lidhje e tyre quhet shkrim me shkronja dore.

Me kalimin e kohës ti do të krijosh mënyrën tënde të të
shkruarit, shkrimin tënd personal.

Tani në fillim çdo shkronjë
është akoma e shtypur në letër.
Kjo mënyrë e të shkruarit quhet shkrin shtypi.
Është qesharake!
Ti shkruan me shkrim shtypi,
një shkrim shtypi i shkruar me dorë.

Ww

Këqyre me kujdes shkronjën W!
Aty ti këqyr vetëm pikën e madhe.
Kjo shkronjë shkruhet me një lëvizje:
Bëj një vizë të pjerrët nga lart poshtë,
bëj majën poshtë dhe ngjitu përsëri pjerrtas,
bëj majën sipër dhe zbrit përsëri pjerrtas poshtë,
bëj majën poshtë dhe ngjitu përsëri pjerrtas sipër.

E gjithë kjo rrugë e gjatë nuk është gjë tjetër
veçse një vizë e përthyer tri herë.
Edhe W-ja e madhe, edhe w-ja e vogël
shkruhen njëlloj.

Oo

Tani këqyri me kujdes O-në dhe o-në:
Pika e madhe ndodhet sipër në të djathtë.
Viza e lakuar ngrihet sipër dhe bën një hark
majtas në anën tjetër rrethepërqark,
deri sa shigjeta e takon pikën.
Përsëri edhe O-ja e madhe,
edhe o-ja e vogël shkruhen njëlloj

Wo...?

W-ja dhe o-ja të lidhura bashkë formojnë fjalën wo.
Kjo fjalë ndodhet në krye të shumë pyetjeve
dhe në këtë pozicion gjithmonë me W të madhe.
Wo ist meine Mama?
Wo liegt mein allerliebster Stift?
Wo steht der nächste Buchstabe?

Rr

Në të njëjtin rresht ku janë O-ja dhe o-ja
ti do të gesh dy shkronja të tjera fis,
të cilat nuk janë aspak të ngjashme me njëra-tjetrën:
R-ja e madhe dhe r-ja e vogël.

R-ja e madhe ka dy pika,
pra ti e shkruan atë me dy lëvizje.
Duhet të fillosh tek pika e madhe,
vertikalisht nga lart poshtë.
Viza e dytë fillon tek pika e vogël
dhe lakohet djathtas
deri sa bashkohet me vizën
e parë vertikale në mes të saj,
përthyer dhe zbret **pjerrtas** poshtë.

r-ja e vogël ka vetëm një pikë.
Lapsi zbret vertikalisht poshtë,
pastaj tamam mbi këtë vizë ngjitet përsëri lart
dhe lakohet me një hark të vogël djathtas.

Tt

Tani e kanë radhën T-ja dhe t-ja.
Të dyja kanë nga dy pika,
të dyja ti duhet t'i shkruash me dy lëvizje.
Lëvizja e parë tek T-ja e madhe
bëhet vertikalisht nga lart poshtë si tek R-ja.
Pastaj lapsi vendos sipër një çati horizontalisht,
duke u nisur nga e majta në të djathtë.

Vater, Mutter oder große Geschwister lesen vor, wie das Kind mit dem Heft lernen wird.
Das Kind schaut sich im Heft die großen Buchstaben mit den Punkten, Linien und Pfeilen an.

Babai, nëna, motrat e rritura ose vëllezërit e rritur lexojnë me zë të lartë si duhet të mësojë fëmija me fletoren. Fëmija këqyr me kujdes në fletore shkronjat e mëdha me pika, viza e shigjeta.

Tek t-ja e vogël, lëvizja e parë përfundon me një hark të vogël djathtas. Lëvizjen e dytë ti me siguri di ta shpjegosh vetë.

Wort Tor

A mund të shkruhen tani me këto katër shkronja fjalë të reja?

Po mund të shkruhen! Ti mund të shkruash të tilla!
P.sh. fjala Wort ose fjala Tor ose ...
Këqyre listën në fund të fletores!
Por ka edhe fjalë të tjera, të cilat ti mund t'i shkruash tani.

Me çdo shkronjë të re që ti mëson rishtas, mund të shkruhen fjalë të reja. Dhe së shpejti ti mund të shkruash fjalë pa numërim.

Është kjo gjë sikur të bësh magji?
Njeriu mund të mendojë, po, kështu është.
Por në të vërtetë ne, shkronjat, vetëm se jemi jashtëzakonisht të lëvizshme Secila prej nesh ndodhet në shumë fjalë.
P.sh. e-në e vogël ti mund ta gjesh kudo.

Üben und Können

Në pesë faqet në fund të fletores secila prej nesh, shkronjave, të tregon ty si dëshiron të shkruhet brenda vizave ndihmëse, kur ti do të na shkruash në fletore.

Vizat ndihmëse përcaktojnë sa mund të zgjatemi ne nga sipër dhe nga poshtë, me qëllim që të dukemi sa më bukur dhe të mos na ngatërrojnë me njëra-tjetrën.

Por të lutem në fillim ushtroje dorën pa vizat ndihmëse dhe jo në fletore me çdo çift prej nesh, shkronjave, veç e veç, pastaj duke na këmbyer me njëra tjetrën dhe pastaj ushtroje fjalët e reja.

E mira është të ushtrosh me laps mbi një dërrasë të vogël të zezë ose mbi një copë letër.

Bëj kujdes të vëresh kur shkruan si lindin shkronjat nga lëvizja e dorës. E ndjen ti dërrasën e zezë letrën, lapsin, dorën tënde, çdo gisht tëndin, lëvizjen?
Më së miri ti ia del mbanë me ne, shkronjat, po të na shkruash ngadalë e me kujdes.

Ushtroje dorën aq shumë derisa ajo të na shkruajë ne, shkronjave, vetvetiu. Bëj kujdes që kur shkruan ta mbash lapsin në atë pozicion që të tregohet në ilustrim për dorën e majtë ose të djathtë.

Shfletuje fletoren, këqyri pozicionin e duarve dhe kopjoje atë sa më mirë që të jetë e mundur!

Ti dëshiron ta mbash lapsin ndryshe, sepse pozicioni që tregohet në ilustrim është tepër i lodhshëm për dorën tënde?

Atëherë përpigu që ta mbash lapsin sa më ngjashëm. Ky është një pozicion, i cili duhet ta bëjë të shkruarit të kollajshëm nëse dora është e çlirët dhe ti ushtron me durim.

Schreiben und Spinnen

Në fletore ti ke për çdo çift shkronjash një fletë bosh prej letre të bardhe e jo të lëmuar Në faqen e parme shkruaj me kujdes. Në faqen e pasme lejohet të bësh marrëzira.

Poshtë faqes mbi të cilën duhet të shkruash, ti duhet të vendosësh fletën A ose B me vizat ndihmëse. Vizat mund të dallohen lehtë dhe të ndihmojnë të shkruash bukur e brenda rreshtit.

Kur pasi të kesh mbaruar së shkruari ti e heq fletën me viza, shkronjat që ke shkruar ti duken po aq të bukura e krenare në fletën e bardhë sa ato të shembujve.

Për një punë të tillë ty të nevojitet një laps i mirë e i butë, me të cilin ti mund të shkruash lehtë një vizë, pa qenë nevoja të sforcohesh.

Faqen e pasme të fletës ku duhet të shkruash, ti mund ta përdorësh pa qenë nevoja të vësh poshtë fletën me vizat ndihmëse, atë ti mund ta përdorësh për të vizatuar e shkruar sipas dëshirës viza me ngjyra të ndryshme, modele e figura të formuara nga pika, rrathë ose shkronja ...

Vorlesetext 1 im Heft **achtsam schreiben lernen** auf ALBANISCH.

Vater, Mutter oder große Geschwister lesen vor, wie das Kind mit dem Heft lernen wird.
Das Kind schaut sich im Heft die großen Buchstaben mit den Punkten, Linien und Pfeilen an.

Teksti i leximit 1 në fletoren **achtsam schreiben lernen** në SHQIP.

Babai, nëna, motrat e rritura ose vëllezërit e rritur lexojnë me zë të lartë si duhet të mësojë fëmija me fletoren. Fëmija këqyr me kujdes në fletore shkronjat e mëdha me pika, viza e shigjeta.

Aty ti mund të bësh edhe marrëzira!
Por: përdor lapsa me ngjyra, jo lapsa kimikë!

Kur të hapësh fletën tjetër
ti përsëri duhet të vendosësh poshtë saj fletën me viza
ndihmëse,
e cila të ndihmon të shkruash
një shkronjë ose fjalë të re.
Cila nga shkronjat duhet të vijojë?
Dhe cila nga fjalët e ka radhën tani?
Këqyr me kujdes në fund të fletores!

Dhe të lutem mos harro: çdo gjë të re
nuk duhet ta ushtrosh qysh në fillim në fletore.
Në fletore duhet të mbetet e shkruar vetëm
ajo pjesë për të cilën ti je vërtet krenar,
jo shkarravitjet e fillimit.

Ne, shkronjat, të urojmë ty:

Viel Glück
mit uns allen!

links

Ata që shkruajnë
me dorën e majtë
e shtyjnë fletoren në të majtë
dhe e vendosin atë pjerrtas mbi tavolinë.
Dora qëndron poshtë **vizës së lakuar**.



rechts

Ata që shkruajnë
me dorën e djathtë,
e shtyjnë fletoren në të djathtë
dhe mund ta lënë atë drejt.



Gishti i madh dhe dy gishtat e parë mbajnë lapsin,
mundësisht sa më çlirët dhe pranë majës së lapsit.
Dy gishtat e tjerë nuk bëjnë asgjë.
Gjatë të shkruarit dora mbështetet lehtë në këndin e vet
dhe rrotullohet ndoshta fare pak nga brenda.
Maja e lapsit e fërkon me pak forcë letrën.
Duke e mbajtur dorën çlirët, edhe të shkruarit do të bëhet i kollajshëm!

Vater, Mutter oder große Geschwister lesen vor, wie das Kind mit dem Heft lernen wird.
Das Kind schaut sich die Rückseite des Heftes mit Bildern, Wörtern und Buchstaben an.

Babai, nëna, motrat e rritura ose vëllezërit e rritur lexojnë me zë të lartë si duhet të mësojë fëmija me fletoren. Fëmija këqyr me kujdes faqen e pasme të fletores me ilustrime, fjalë e shkronja.

Teksti i leximit për faqen me ilustrime

Në faqen e pasme të fletores tënde ti mund të këqyrësh shumë ilustrime të vockla me ngjyra, sipër tyre ndodhen fjalë të shkruara me ngjyrë të zezë, poshtë tyre ndodhen shkronja me ngjyrë të kaltër dhe pranë tyre ti mund të këqyrësh pika të verdha. Lër dikë të t'i lexojë krejt fjalët me zë të lartë!

Dy shkronjat me ngjyrë të kaltër ndodhen fare pranë njëra-tjetrës. Ato janë fis ndërmjet tyre, si një vëlla i vogël e një vëlla i madh. Dy shkronjat janë shumë të ngjashme me njëra-tjetrën, ose janë pak të ngjashme me njëra-tjetrën, ose nuk janë fare të ngjashme me njëra-tjetrën.

Vëllai i madh poshtë ilustrimit është shkronja e parë në fjalën që ndodhet sipër. Shpesh qëllon që edhe vëllai i vogël të ndodhet pranë tij ose në ndonjë fjalë tjetër. Vëllai i madh mungon dy herë në fjalën sipër, por tek kjo fjalë ti mund të këqyrësh vëllain e vogël.

Përpiqu një herë të gjes, si mund të shqiptohet një shkronjë! Ilustrimi dhe fjala do të të ndihmojnë për këtë gjë. Megjithatë kjo gjë mund të jetë e vështirë: Në fqinjësi me shkronjat e tjera brenda një fjale, çdo shkronjë ndryshon pak gjatë shqiptimit. Dëgjo me kujdes si tingëllojnë K-ja e madhe dhe k-ja e vogël në fjalën Krokodil!

Nëse ti shkruan bukur, me dëshirë e me dorë të çlirët dy shkronja, atëherë shkruaji ato në fletore: në fillim vëllezërit veç e veç, herë njërin, herë tjetrin, pastaj shkruaj fjalët brenda të cilave ndodhen ata.

Çdo fjalë të re shkruaje disa herë. Këqyr më parë gjithçka me kujdes! Çdo shkronjë! Shqiptoje më parë për veten tënde: Çfarë dëgjon kur e bën këtë gjë? Çfarë nuk dëgjon? Ushtro për një kohë të gjatë deri sa të kesh vërejtur mirë gjithçka para se të shkruash në fletore. Në fletore duhet të shkruash vetëm një faqe, për të cilën ti të jesh krenar!

Këtë faqe tregojta dikujt, i cili di të shkruajë shumë bukur. Tani ti di ta bësh këtë gjë! – Ta thotë ai këtë fjali? Atëherë pranë vëllezërve në pikën e verdhë ti mund të bësh shenjën tënde dhe të thuash me zë të lartë: KËTO DY SHKRONJA DI T'I SHKRUAJ!

Me kalimin e kohës për shumë shkronja ti do ta kesh përherë e më të lehtë. Përherë e më shumë fjalë që të janë ngulitur në kokë ti mund t'i shkruash bukur e me dorë të çlirët. Të gjitha fjalët që ti dëshiron të shkruash!

Ti ke dëshirë të shkruash fjalë për të cilat nuk ke një shembull para sysh? Shqiptoji ato vetëm për veten tënde! Dëgjoji me kujdes! Tani shkruaji ato, sa më mirë që të mundesh! Pastaj lër dikë të të shpjegojë çka ka qenë e re për ty tek këto fjalë. Shumë fjalë janë tinëzare. Ti nuk mund të dëgjosh nga shqiptimi si duhet të shkruhen ato!

Madje ka edhe fjalë që shkruhen dy mënyrash: P.sh. nganjëherë Cirkus, nganjëherë Zirkus, por shqiptimi është të dyja herët njëlloj.

Kjo ishte e gjitha? Jo! Shembujt me ngjyrë të kaltër në fletore janë për shkrimin e

shtypit, por të shkruar me dorë: shkurt hDS.

hDs

Kurse të gjitha fjalët me ngjyrë të zezë janë të shkruara me shkrim shtypi të zakonshëm: shkurt DS. Dy prej shkronjave kanë një pamje krejt tjetër nga ato që shkruan ti kur paraqiten me shkrim shtypi.

Shkronja a dhe shkronja g tek fjala Papagei janë për ty

a g

Nëse shkronjave **a o u** u vendosim nga dy pika sipër, ato shndërrohen në **ä ö ü**.

a o u ä ö ü

Këtë gjë ti mund ta shikosh tek fjalët Mädchen, Vögel dhe Tüte.

Një nga shkronjat u nevojitet pak fjalëve dhe nuk ndodhet në faqen me ilustrime, por ti mund ta gjesësh atë diku tjetër në fletore: është **ß**-ja

ß

Në grupin tonë prej 26 shkronjash ka shumë gjëra të çuditshme për të zbuluar, dhe në botën e madhe ka dhe shkronja të tjera krejt të ndryshme. Për fat ti duhet të mësosh tani vetëm shkronjat në gjermanisht. Dhe këto nuk janë dhe aq shumë.

Por me këto pak shkronja

Vorlesetext 2 im Heft **achtsam schreiben lernen** auf ALBANISCH.

Vater, Mutter oder große Geschwister lesen vor, wie das Kind mit dem Heft lernen wird.
Das Kind schaut sich die Rückseite des Heftes mit Bildern, Wörtern und Buchstaben an.

Teksti i leximit 2 në fletoren **achtsam schreiben lernen** në SHQIP.

Babai, nëna, motrat e rritura ose vëllezërit e rritur lexojnë me zë të lartë si duhet të mësojë fëmija me fletoren. Fëmija këqyr me kujdes faqen e pasme të fletores me ilustrime, fjalë e shkronja.

ti mund të shkruash
më vonë fjalë pa fund.
Është sikur të bësh magji, apo jo!

Ato çka ke shkruar ti,
mund t'i lexojë pastaj gjithkush,
edhe nëse ti atë moment ndodhesh diku tjetër,
ndoshta edhe shumë larg.

Dhe ata që të njohin ty mirë, dinë të dallojnë madje edhe
shkrimin tënd midis të tjerëve.